

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.00/73-2023	Data: 26.04.2023	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe nenit 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 26.04.2023 shqyrtoi dhe miratoi propozimet e Kryetarit të Komunës për ndarjen e buxhetit dhe tejkalimin e THV 2022 dhe mori këtë:

V E N D I M I

PËR NDARJEN E BUXHETIT DHE TEJKALIMIN E THV 2022

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për ndarjen buxhetore dhe tejkalimin e THV 2022, si dhe për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2022 për shpenzim në vitin fiskal 2023, në vlerë prej: 397,990.73 €, si në vijim:

- I. Shuma totale e të hyrave vetanake të tejkaluara në periudhën Janar – Dhjetor 2022 duke përfshirë të gjitha të hyrat është: 183,306.27 €, shuma e planifikuar për vitin 2022 është 1.160,615.00 €, ku shihet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake për vitin 2022 në vlerë prej: 183,306.27 €, në këtë shumë janë të përfshira edhe gjërat e trafikut.
- II. Total shuma prej 397,990.73 €, të bartet si në vijim:

Nga nën-programet buxhetore nga burimi i financimit 21 shuma prej 397,990.73 €:

1. Kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime: 34,096.84 €, janë nga bartjet e mjeteve të pashpenzuara në vitin fiskal 2022

1.1. Në kuadër të programit Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod, 470 nën-programi Bujqësi – Istog me kod 47017, shuma prej 16,469.57 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Mallra dhe Shërbime, në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod, 470 nën-programi Bujqësi – Istog me kod 47017.

1.2. Në kuadër të programit Arsim dhe Shkencë me kod 920, në nën programin Arsimi fillor, i mesëm i ulët – Istog me kod 93480, shuma prej 17,627.27 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Mallra dhe Shërbime, në programin Arsim dhe Shkencë me kod 920, nën-programi Arsimi fillor, i mesëm i ulët – Istog me kod 93480.

2. **Kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale: 266,494.95 €, nga të cilat 157,738.68 €, janë nga bartjet e mjeteve të pashpenzuara në vitin fiskal 2022, ndërsa shuma prej 108,756.27 €, janë nga tejkalimi i të hyrave të vitit fiskal 2022.**

2.1. Në kuadër të programit Administrata dhe Personeli me kod 163, nën-programi Administrata – Istog me kod 16317, shuma prej 148,708.20 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, në programin Administrata dhe Personeli me kod 163, nën-programi Administrata – Istog me kod 16317, barten në këtë projekt:

1. “Blerja e veturave për nevojat e Administratës Komunale ” kodi (53917) në shumë prej 148,708.20 €.

2.2. Në kuadër të programit Buxhet dhe Financa me kod 175, nën-programi Buxheti – Istog me kod 17517, shuma prej 27,440.00 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, në programin Buxhet dhe Financa me kod 175, nën-programi Buxheti – Istog me kod 17517, barten në këto projekte:

1. “Ndërtimi i rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe Lagjen Blakaj në Llukafç ”, kodi (53916) në shumë prej: 10,000.00 €.

2. “Ndërtimi i rrugëve në Fshatrat e Komunës së Istogut”, kodi (52269) në shumë prej : 17,440.00 €.

2.3. Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia me kod, 180 nën-programi Infrastruktura Rrugore – Istog me kod 18017, shuma prej 40,000.00 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia me kod, 180, nën-programi Infrastruktura Rrugore – Istog me kod 18017: barten në këtë projekt:

1."Ndërtimi i rrugës dhe rrethojës së varrezave në fshatin Cerrcë",
kodi (I Ri) në shumë prej: 40,000.00 €.

- 2.4. Në kuadër të programit Zyra e Komiteteve me kod, 195 nën-programi Zyra komunale për komitete dhe kthim - Istog me kod 19585, shuma prej 19,050.00 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, Zyra e Komiteteve me kod, 195, nën-programi Zyra komunale për komitete dhe kthim - Istog me kod 1958, të barten në këtë projekt:

1." Ndërtimi i rrugës "Bashi "në Dobrushë", kodi (52227) në shumë prej 7,180.00 €.

2." Ndërtimi i rrugës "Azem Shkreli" në Llukafç të Begut-Mostarska", kodi (52229) në shumë prej 8,440.00 €,

3."Ndërtimi i rrugës "Azem Shkreli" në Llukafç të Begut", kodi (52228) në shumë prej 3,430.00€,

- 2.5. Në kuadër të programit Zhvillim Ekonomik me kod 470, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik- Istog me kod 48017, batet shuma prej 12,067.50 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, Zhvillim Ekonomik me kod 470, nën-programi nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik- Istog me kod 48017, të barten në këto projekte:

1.Ndërtimi i rrugës"Dëshmorët Salihaj " në Shushicë të Ulët, kodi (53921) në shumë prej 2,082.00 €.

2.Ndërtimi i rrugës në lagjen Hajziraj në Zhakovë, kodi (52307) në shumë prej 9,985.50 €.

- 2.6. Në kuadër të programit Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale me kod, 730 nën-programi Shërbimet e shëndetësisë primare - Istog me kod 74000, shuma prej 4,645.15 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale me kod, 730, nën-programi Shërbimet e shëndetësisë primare - Istog me kod 74000, të barten në këtë projekt:

1."Ndërtimi i Ambulancës në Fshatin Veriq", kod (48845) në shumë prej 4,645.15 €.

- 2.7. Në kuadër të programit Kulturë, Rini, Sport me kod, 850, nën-programi Shërbimet Kulturore - Istog me kod 85017, shuma prej 14,584.10 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, Kulturë, Rini, Sport me kod, 850, nën-programi Shërbimet Kulturore - Istog me kod 85017, të barten në këto projekte:

1."Ndërtimi i mureve pas portave dhe ndërtimi i zhveshtoreve faza 3 në stadiumin e futbollit Demush Mavraj", kod (52844) në shumë prej 2,319.10 €.

2."Ndërtimi i Qendrës Rinore në Uçë", kod (48903) në shumë prej 12,265.00 €.

3. Kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere: 97,398.94 €, nga të cilat 22,848.94 €, janë nga bartjet e mjeteve të pashpenzuara në vitin fiskal 2022, ndërsa shuma prej 74,550.00 €, janë nga tejkalimi i të hyrave të vitit fiskal 2022.

- 3.1. Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia me kod, 180 nën-programi Infrastruktura Rrugore - Istog me kod 18017, shuma prej 59,999.20 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Subvencione dhe Transfere, Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia me kod, 180, nën-programi Infrastruktura Rrugore - Istog me kod 18017.

- 3.2. Në kuadër të programit Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale me kod, 730 nën-programi Shërbimet e shëndetësisë primare - Istog me kod 74000, shuma prej 10,000.00 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Subvencione dhe Transfere, Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale me kod, 730, nën-programi Shërbimet e shëndetësisë primare - Istog me kod 74000.

- 3.3. Në kuadër të programit Kulturë, Rini, Sport me kod, 850, nën-programi Shërbimet Kulturore - Istog me kod 85017, shuma prej 9,299.74 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Subvencione dhe Transfere, Kulturë, Rini, Sport me kod, 850, nën-programi Shërbimet Kulturore - Istog me kod 85017.

- 3.4. Në kuadër të programit Arsim dhe Shkencë me kod 920, në nën programin Arsimi i mesëm i lartë, me kod 94680, shuma prej 18,100.00 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Subvencione dhe Transfere, në programin Arsim dhe Shkencë me kod 920, në nën programin Arsimi i mesëm i lartë, me kod 94680

Vërejtje: Është respektuar struktura e shpenzimeve nga viti fiskal 2022 nga fondi burimor 21.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Drejtori për Shërbime Publike, Drejtori për Arsim dhe Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport,

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Ministra e Financave, Punës dhe Transferit, Kryetari i Komunës, Drejtori për Buxhet e Financa, Zyrtari kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova


